

**Njoftim për hapjen e studimeve në ciklin e dytë të studimeve
Master Profesional dhe Master shkencor
pranë FEA**

Universiteti Bujqësor i Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, ofron në vitin akademik **2024- 2025**, programet e ciklit të dytë të studimeve si mëposhtë:

Master i Shkencave

- Financë - Kontabilitet (120 kredite)
- Administrim i Ndërmarrjeve (120 kredite)
- Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Ekonomia Cirkulare (Diplomë Duale -120 kredite)
- Informatike Biznesi (120 kredite)
- Marketingu i Ushqimit dhe Biznesi Digjital (Diplomë Duale - 120 kredite)

Master Profesional

- Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit (120 kredite)
- Ekonomi dhe Politika Agrare (120 kredite)
- Sipërmarrje dhe Inovacion në Ekonomi Cirkulare (Diplomë Dyfishe - 60 kredite)
- Financë Bankë (120 kredite)
- Kontabilitet dhe Auditim (120 kredite)
- Menaxhim Informacioni në Agrobiznes (120 kredite)
- Menaxhim i Turizmit Rural (120 kredite)

Aplikimet për ciklin e dytë të studimeve deri në 04.10.2024

Dokumentat:

- 1) Diplomën e maturës shtetërore së bashku me fotokopjen e notave ose fotokopjen e tyre të njehsuar me origjinalin.
- 2) Diplomë ose fotokopje të njehsuar me origjinalin të ciklit të parë të studimeve.
- 3) Formularin e aplikimit.
- 4) Fotokopje e kartës së identitetit.
- 5) Dy fotografi personale.
- 6) Mandat arkëtimi për regjistrimin.

Regjistrimet kryhen pranë sekretarive të departamenteve.

Programi i studimit	Salla
Administrim i Ndërmarrjeve (MSh) Marketingu i Ushqimit dhe Biznesi Digjital (MSH) Menaxhimi i Ndërmarrjeve të Agrobiznesit (MP)	A 211
Ekonomi dhe Politikat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (Ekonomia Cirkulare) (MSh) Ekonomi dhe Politika Agrare (MP) Sipërmarrje dhe Inovacion në Ekonomi Cirkulare (MP)	A 222
Financë - Kontabilitet (MSh) Financë Bankë (MP) Kontabilitet dhe Auditim (MP)	B 214
Informatikë Biznesi (MSH) Menaxhim Informacioni në Agrobiznes (MP)	A 127
Menaxhim i Turizmit Rural (MP)	A 205

KRITERET

Master Shkencor

Kanë të drejtë të **aplikojnë** për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën “**Master i Shkencave**” individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “**Bachelor**”, “**Master Profesional**” në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë vijojnë:

- **kriterin e meritës.** Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë (bachelor) në *profilet e ekonomisë, të jetë 7.5 e lart.* Në rast se ka ende kuota të lira, kufiri i poshtëm për mesataren e ciklit të parë bachelor do të vendoset me vendim dekanati.
- **kriterit e rëndësisë** (koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të FEA_s).
- **kuotave të paracaktuara nga FEA.**

Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin “**Master i Shkencave**” do të jetë rezultat i produktit: **notë mesatare në bachelor*koeficienti** (Sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet); duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste brënda kuotave të paracaktuara nga FEA

Master Profesional

Kanë të drejtë të **aplikojnë** për t'u regjistruar në programin e studimeve për të fituar Diplomën “**Master Profesional**” individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “**Bachelor**”, në sistemin me kohë të plotë dhe të pjesëshme si dhe plotësojnë kriteret akademike si më poshtë vijojnë:

- **kriterin e meritës.** Nota mesatare e ponderuar e studimeve të ciklit të parë (bachelor).
- **kriterin e rëndësisë** (koeficienti i profilit të studimeve bachelor sa i takon përputhshmërisë me fushat dhe programet e studimit të FEA_s).
- **kuotave të paracaktuara nga FEA.**

Përzgjedhja e kandidatëve fitues në programin “**Master Profesional**” do të jetë rezultat i produktit: **notë mesatare në bachelor*koeficient** (Sipas profilit dhe programit të studimit që aplikohet); duke gjeneruar kështu një listë vlerësimi e cila shpall si fitues të renditurit sipas kësaj liste brënda kuotave të paracaktuara nga FEA